



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS NË SHËRBBIM  
TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ  
DHE TË STUDENTËVE”**

FINANCUAR NGA MINISTERIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR  
VITIN AKADEMIK 2022-2023



**Ekipi i projektit:**

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI

Dr. Elvana SHTËPANI

---

## Aktivitetet mbi realizimin e punës në fazën e dytë dhe finale:



### **PUNIMET SHKENCORE TË REALIZUARA SI REZULTAT I INSTALIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR**

Qëllimi kryesor i projektit është përmbushur duke ngritur hapësira të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, të cilat tashmë u ofrohen studentëve të të tre cikleve të studimit, kërkuesve shkencorë të UT-së si dhe studentëve apo kërkuesve shkencorë të cilët bëhen pjesë në UT nëpërmjet programeve të shkëmbimit. Gjithashtu këto ambiente tashmë po përdoren për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësve kulturorë dhe stafit të UT-së që dëshirojnë të përditësojnë dijet e tyre në fushat përkatëse. Këto trajnime janë ofruar nga profesorë të kualifikuar nga Universiteti i Poitiers, Francë, profesorë të huaj dhe ekspertë vendas të ftuar me mbështetjen e Agjencise Universitare të Frankofonisë (AUF) si edhe profesorë nga stafi i FGJH-së.

Në periudhën raportuese janë zhvilluar mbi 46 aktivitete shkencore: simpoziume, takime “Tavolina të Rrumbullakëta” me partnerët e fakultetit, me Alumini dhe në përmbushje të nevojave të punës kërkimore të secilit departament, webinarë, leksione të hapura, etj.

Fotot më poshtë janë evidencë e aktiviteteve shkencore të realizuara





UNIVERSITA DI TIRANA  
FACOLTÀ DI LINGUE STRANIERE  
DIPARTIMENTO DI ITALIANO

XIV° Convegno Internazionale  
di Studi di Italianistica

LETTERATURA  
DIDATTICA  
TRADUZIONE

Ora 10:10 AM  
17 Maggio 2023  
Aula 309, Facoltà di Lingue Straniere

Spanjishtja  
Gjuhë Globale

Konferencë mbi rëndësinë dhe mundësitë  
që ofron mësimi i gjuhës spanjolle  
në bashkëpunim me Institutin Servantes në Romë  
dhe Departamentin e Studimeve Hispanike  
të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

15 Maj, Ora 09:00,  
Godina Liria, Qyteti Studenti, Rruga Arben Broci

Në përfundim  
të konferencës  
Koncert special nga  
kantautori shqiptar,  
Vlasheni Sata,  
me një repertor  
me muzikë  
dhe poezi spanjolle  
dhe latino-amerikane

UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUJHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUJHËS GREKE &  
DEPARTAMENTI I GJUJHËS ANGLEZE &  
UNIVERSITETI IONIAN, GREQI  
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANË  
DEPARTAMENTI I GJUJHËVE TË HUAJA PËRKTHIMIT DHE INTERPRETIMIT &  
FONDACIONI GREK I KULTURËS

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

PËRKTHIMI DHE KOMUNIKIMI,  
SFIDAT DHE PËRPARËSITË NË  
RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

26 PRILL 2023  
ORA 09:00 AM

Salla "EUROPA"  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

departamenti.greqisht@unitir.edu.al

KONFERENCA SHKENCORE  
NDËRKOMBËTARE STUDENTORE

"Kërkimi shkencor dhe edukimi  
në perspektivën e studentëve dhe  
studiuësve të rinj"

UT FLET ME ZËRIN E STUDENTËVE!

18-19 MAJ 2023

Dita I: Godina "Liria", Qyteti Studenti  
10:30

Dita II: Fakulteti Ekonomik  
9:00



DEPARTAMENTI I GJUJHËS FRËNGE  
FAKULTETI I GJUJHËVE TË HUAJA  
UNIVERSITETI I TIRANËS

Organizon veprimtarinë shkencore

INTEGRIMI I MJETEVE DIGJITALE  
NË PEDAGOGJINË E KLASËS SË PËRMBYSUR

Tavolinë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e  
Znj. CYNTHIA EID  
Presidentja Federatës Ndërkombëtare të Mësuesve të Gjuhës Frënge  
Eksperientë në metodologji të klasës së përblytur

6 qershor 2023  
10:00-12:00

Salla "Rozafa"  
FGJH

MULTILINGUAL EDUCATION  
IN LINGUISTICALLY DIVERSE  
CONTEXTS (MELDC 3)

equinox BRILL

INTERNATIONAL CONFERENCE

University of Tirana | Faculty of Foreign Languages  
Rr. Elbasanit Tirana | Albania | AL 1001

22 – 23 September 2022

KONFERENCË  
NDËRKOMBËTARE

"SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË  
KULTURORE TË FLASË?"

KREATIVITET DHE NDËRMJETËSIM NË  
NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

8-9 Dhjetor 2022

Universiteti i Tiranës,  
Filiali Sarandë, Shqipëri


**Universiteti i Tiranës**  
 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja


**DITA EVROPIANE E GJUHËVE**

**“Promovimi i mësimit të gjuhëve të huaja gjatë gjithë jetës si vektorë të rëndësishëm të edukimit qytetar dhe të suksesit profesional”**

26.09.2023  
 Ora 10:00  
 Salla “Evropa”

@fakulteti.gjuhevetehuaja.ut www.fgjh.edu.al





**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
 FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Ekipi kërkimor i didaktikës i Departamentit të Gjuhës Frënge organizon workshopin me temë:

**KUADRI EVROPIAN I PËRBASHKËT I REFERENCAVE PËR GJUHËT-VOLUMI PLOTËSUES DHE NDRËMJETËSIMI GJUHËSOR**

Salla e Trajimeve 215  
 DATA 25. 04. 2023  
 ORA 10:00




**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
 UNIVERSITÉ DE TIRANÉ

**SIMBOLË VËRBIË TË V GËRSHOR 2023**  
 “Potenciali i Miratimit Kulturor të Krahëve të Evropës së Shqipërië të territorit”  
 Vendi: SALLA EVROPA - FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
 Ekipi: 2023 - 5 - 9 Junë 2023  
 Koordinator/Coordinatrice: Prof. Dr. Elmira KROMIDA, Dr. Drita BIRA

**PROGRAMI**

Dita / Date	Librimi / Libération de l'Étude	Programi / Programme
Dita 1 / 06.06.2023	Prof. Pierre FRESTIER Ekipi: Krahë të Evropës së Shqipërië të territorit R&D Communication Espoir pour les Initiatives Culturelles de l'Europe	Hajje e shkolle të reja Gëzimet e Evropës së Shqipërië të territorit Initiatives kulturelles të Krahëve të Evropës (prezentim i projektit, vlerësim i konceptit dhe organizimi i tyre) Les Initiatives Culturelles de l'Europe (présentation du projet, discussion des initiatives et de leur organisation)
Dita 2 / 06.07.2023	Elma DE BENSNA Prisjetimi e prezencës evropiane për Evropën e Francës Responsabilité des projets européens pour la France	Initiatives kulturelles et rôle modèle des villes européennes Les initiatives culturelles: un modèle de développement économique et culturel / l'exemple de la France
Dita 3 / 06.08.2023	Prof. Pierre FRESTIER Prof. Dr. Rozeta HANSHARI Prof. Dr. Sokol ANHEMI Profesori, Universiteti i Tiranës	Initiatives kulturelles të Shqipërië (prezentim i iniciativës së organizimit të reja: (për hapësirat, shkollat) - Artim, Ena, Vendi, Ullin, Tërbësia kulturele, Rreza Evropiane) Les initiatives culturelles et actions / présentation de l'initiative / organisation, démarrage de ces initiatives - Artim, Ena, Vendi, Ullin, parerime për Vite Evropiane.



Laboratorët kërkimor shkencorë bëjnë të mundur kryerjen e hulumtimeve në mënyrë më efektive dhe kanë ofruar mundësi të reja për të zhvilluar qasje të reja metodologjike, mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi në disiplina ekzistuese dhe ato të reja. Për më tepër, ata ofrojnë mundësi për përcimin e të dhënave dhe rezultateve kërkimore duke përdorur mënyra të reja. Këto mjedise po shërbejnë si mjet për të bërë ndryshime thelbësore në procesin, përmbajtjen dhe format e mësimdhënies duke bërë që të arrihen më mirë dhe më me efikasitet qëllimet e arsimit dhe kërkimit: cilësi, integritet dhe arsimim për të gjithë.

Punimet shkencore të kryera në periudhën raportuese shtator 2022 – shtator 2023 tejkalojnë ato të planifikuara në projekt. Më poshtë paraqiten të detajuara rezultatet në shumë aktivitete kërkimore:

- 42 studentë doktorantë janë regjistruar në ciklin e tretë, të cilët punojnë në kërkime shkencore dhe projekte kërkimore;
- 13 kërkues shkencor kanë përfituar titullin “Profesor i Asociuar” dhe 1 ka marrë titullin “Profesor”, të cilët kanë sjellë rritje të studimeve, botimeve të artikujve shkencorë, botimeve të referimeve në revista, monografi;
- 2 Konferenca Ndërkombëtare në rang Fakulteti janë mbajtur brenda periudhës raportuese;
- 6 Konferenca Ndërkombëtare nga Departamentet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja janë realizuar me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve ndërkombëtare (Departamenti i gjuhës frënge, italiane, gjermane, spanjolle, greke, ruse);
- 1 Konferencë Ndërdepartamentale nga Studentët më të mirë të programeve të tre cikleve të studimit është realizuar në nivel universiteti ku studentet e FGJH-së morën pjesë me 16 artikuj nga fushat kërkimore të gjuhësisë, letërsisë dhe metodave të reja TIK;


Rritja cilësore në kualifikimin profesional të stafit akademik e ndihmës akademik është reflektuar me rritjen e dhënies së gradave e titujve dhe si rritjen e cilësisë së shërbimeve. Janë krijuar 18 grupe mësimore kërkimore që kanë veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore si dhe janë organizuar trajnime për kërkuesit e rinj mbi mënyrën e shkrimit të artikujve, prezantimit të ecurisë së punës së tyre shkencore dhe shkrimit të tezave.

Gjithashtu janë realizuar trajnime për mësuesit e rinj mbi përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Fotot e mëposhtme evidencë të disa prej trajnimeve të kryera për mësuesit e rinj gjatë periudhës raportuese:



Në fotot më poshtë paraqiten Konferencat Shkencore Ndërkombëtare që priten të realizohen brenda muajit dhjetor 2023.



Krijimi i laboratorëve të teknologjisë së lartë dhe zhvillimi i infrastrukturës së avancuar kanë luajtur një rol vendimtar në suksesin e projekteve të ndryshme kërkimore dhe zhvillimore të propozuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, UT. Një nga këta është projekti i fituar nga Agjencia Universitare e Frankonisë (AUF) me titullin: *“Integrimi i teknologjisë digjitale në metodologjitë e mësimdhënies/mësimnxënies dhe sfidat e trajnimit të mësuesve – INTICE”* – Drejtuar nga Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA, koordinator i projektit, në konsorcium ekipin e studiuësve nga Universiteti i Zagrebit (Kroaci).

Ky projekt realizoi objektivat e shumëfishta lidhur me krijimin e profileve dhe tematikave kërkimore të fakulteteve të Universitetit të Tiranës me qëllim krijimin e rrjeteve kërkimore shkencore brenda dhe ndëruniversitare si dhe zhvillimin e kërkimit shkencor ndërdisiplinor. Gjithashtu një prej objektivave të këtij projekti ishte përgatitja e studiuësve të rinj në programet e doktoraturës të financuara, në projekte kërkimore, rekrutimi i doktorantëve në projekte kërkimore dhe mësimore si dhe krijimi dhe standardizimi i programeve postdoktorale, duke u finalizuar me botimin e Guidës: *“Udhëzues me praktikat më të mira për integrimin e mjeteve digjitale në klasat e mësimin të gjuhëve të huaja”*.



Pra, krijimi i laboratorëve dhe infrastrukturës së avancuar në sektorët e teknologjisë së lartë kontribuojnë ndjeshëm në suksesin e projekteve duke mundur rritjen e kërkimit, inovacionit, bashkëpunimit dhe ngritjen e kapaciteteve.